



Ministri Vengu në Bratislavë: Shqipëria, faktor stabiliteti dhe sigurie në rajon



» faqe 3



» faqe 2



GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI VLERËSON BASHKËPUNIMIN ME FSK-në DHE PËRKUSHTIMIN PËR INTEGRIM RAJONAL

Në një takim me komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, gjenerallejtënant Arben Kingji vlerësoi nivelin e lartë të bashkëpunimit mes Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Gjatë takimit u shpreh përkushtimi...

» faqe 4



PËRTEJ UNIFORMËS: NËNË PËRJETËSISHT, HEROINË ÇDO DITË

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Gratë që thyejnë tabutë: Forca dhe guximi mbi uniformë. Në një botë ku forca shpesh shihet si atribut mashkullor, historitë e grave që ndërtojnë karrierë në Forcat e Armatosura frymëzojnë dhe tregojnë se vendosmëria nuk njih kufij. Nënkolonele Arjana Stërgu, me përkushtim, disiplinë dhe pasion për profesionin, ka ndërtuar...

» faqe 6



PRIORITETET STRATEGJIKE të Ministrisë së Mbrojtjes 2025-2029

OBJEKTIVI STRATEGJIK

Shqipëria synon të kthehet në një qendër rajonale të industrisë së mbrojtjes, duke ndërtuar kapacitete të reja, forcuar partneritetet brenda NATO-s dhe modernizuar forcat e saj të armatosura

PRIORITETET KRYESORE

01

BUXHETI I MBROJTJES

Rritje e buxhetit të mbrojtjes me të paktën 2,01% të PBB-së

06

KAPACITETET REAGUESE DHE INOVACIONI

Zhvillimi i aftësive reaguese në territor përmes sistemeve inteligjente dhe funksionalizimit të numrit kombëtar/ndërkombëtar 112

02

INDUSTRIA USHTARAKE "MADE IN ALBANIA"

Prodhimi vendas i municioneve, armatimit të lehtë, mjeteve të blinduara, sistemeve pa pilot dhe mjeteve për emergjencat civile

07

INFRASTRUKTURA KRITIKE DHE MOBILITETI USHTARAK

Modernizimi i infrastrukturës dhe përfundimi i investimeve në Korridorin VIII për lëvizjen e Aleancës, me pikënisje në Porto Romano

03

KAPACITETET DETARE

Zgjerimi i flotës me 3 anije të reja dhe modernizimi i flotës ekzistuese

08

PROJEKTE NË ZBATIM DERI NË 2029

- Përfundimi i kantierit të Spitalit të Traumës
- Ngritja e Shkollës së Aviacionit në Vlorë
- Ndërtimi i Kampusit të Ri të Akademisë së Forcave të Armatosura
- Krijimi i Kompleksit të Inovacionit Uashtarak në Bërzhitë
- Finalizimi i Poligonit Ndërkombëtar në Bizë

04

MBROJTJA CIVILE

Investime në 2 avionë zjarrfikës, flotë të përforcuar tokësore dhe ngritja e 4 qendrave të reja rajonale të emergjencave civile

05

PERSONELI USHTARAK

Vijim i rritjes së pagës së ushtarakëve, duke arritur mesataren e NATO-s deri në vitin 2029



Ministri Vengu në Bratislavë: Shqipëria, faktor stabiliteti dhe sigurie në rajon

Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, mori pjesë në Takimin e Ministrave të Mbrojtjes të Europës Qendrore dhe Ballkanit Perëndimor (CEDC+WB), i zhvilluar këtë vit në Bratislavë të Sllovakisë.

Konferenca kishte në fokus industrinë e mbrojtjes, modernizimin dhe armatimin, si prioritetet kryesore të presidencës sllovaqe.

Në fjalën e tij, ministri Vengu theksoi se Shqipëria është një prodhues stabiliteti dhe sigurie në rajon, falë më shumë se 500 trupave të angazhuara në misionet e NATO-s dhe Bashkimit European, si dhe përmes investimeve të rëndësishme në industrinë e mbrojtjes. Këto përfshijnë prodhimin e sistemeve të artilerisë, dronëve luftarakë, mjeteve të blinduara dhe municioneve.

Ai nënvizoi se këto investime lidhen ngushtësisht me infrastrukturën kritike kombëtare, si Korridori VIII, Porto Romano dhe forcimin e Mbrojtjes Civile:

“Në këndvështrimin tonë, axhenda e anëtarësimit në Bashkimin European dhe fuqizimi i mbrojtjes, si një shtyllë zhvillimi ekonomik dhe qëndrueshmërie kombëtare, shkojnë krah për krah. Ky ishte momenti për të marrë mbështetje domethënëse nga të gjithë kolegët e Europës Qendrore dhe Juglindore për këtë përparësi kombëtare”, – u shpreh ministri Vengu.

Në punime morën pjesë ministrat e Mbrojtjes së Austrisë, Kroacisë, Çekisë, Hungarisë, Sllovakisë, Sllovenisë, si dhe homologët nga vendet e Ballkanit Perëndimor: Bosnja-Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia.



Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu: Shqipëria është një prodhues stabiliteti dhe sigurie në rajon, falë më shumë se 500 trupave të angazhuara në misionet e NATO-s dhe Bashkimit European, si dhe përmes investimeve të rëndësishme në industrinë e mbrojtjes. Këto përfshijnë prodhimin e sistemeve të artilerisë, dronëve luftarakë, mjeteve të blinduara dhe municioneve.



Kryenënoficerët e rajonit diskutojnë fuqizimin e rolit të nënoficerëve në kuadër të iniciativës A5

Gjatë takimeve në kuadër të iniciativës SHBA-Karta e Adriatikut (A5), kryenënoficerët e vendeve anëtare, të atyre vëzhguese dhe Gardave Kombëtare të SHBA-së, zhvilluan diskutime mbi objektivat e sigurisë rajonale dhe rëndësinë e rolit të trupës së nënoficerëve.

Konferenca theksoi se nënoficerët janë shtylla kryesore e ushtrisë në zbatimin e detyrave operative, me fokus në rritjen e bashkëpunimit dhe koordinimit gjatë menaxhimit të emergjencave civile, zhvillimin e trajnimeve të përbashkëta dhe forcimin e gatishmërisë së trupës.

Ky forum u konsiderua një hap i rëndësishëm drejt harmonizimit të praktikave dhe standardeve rajonale në fushën e sigurisë dhe menaxhimit të emergjencave.



Gjeneralletenant Arben Kingji vlerëson bashkëpunimin me FSK-në dhe përkushtimin për integrim rajonal

Në një takim me komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralletenant Bashkim Jashari, gjeneralletenant Arben Kingji vlerësoi nivelin e lartë të bashkëpunimit mes Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Gjatë takimit u shpreh përkushtimi për forcimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi, duke përfshirë finalizimin e pritshëm të një plani 3-vjeçar të përbashkët.

“Siç theksova edhe gjatë konferencës së përmbyllur dy ditë më parë, politika e dyerve të hapura mbetet parimi themelor i kësaj nisme. Anëtarësimi i Kosovës, i merituar dhe tashmë i vonuar, do të kontribuonte në stabilitetin rajonal”, - deklaroi gjeneralletenant Kingji.

Ai përgëzoi progresin e FSK-së në fushën e modernizimit, zhvillimit dhe ndërveprueshmërisë, dhe ritheksoi mbështetjen e pakursyer të Shqipërisë për pjesëmarrjen e personelit të FSK-së në stërvitje, kurse dhe trajnime të përbashkëta me Aleancën.

Gjeneralletenant Kingji theksoi gjithashtu se Kosova mbetet një çështje parësore e interesit strategjik kombëtar për Shqipërinë, dhe si e tillë diskutohet në çdo takim, forum apo nismë rajonale ku përfaqësohet vendi.



Toga e Batalionit Shumëkombësh në misionin EUFOR demonstroi profesionalizëm dhe disiplinë në stërvitjen “Quick Response-25”

Toga e Batalionit Shumëkombësh, e angazhuar në misionin EUFOR në Bosnje-Hercegovinë, mori pjesë me sukses në stërvitjen ndërkombëtare “Quick Response-25”.

Gjatë aktiviteteve të zhvilluara, efektivët shqiptarë u shquan për disiplinë të lartë, profesionalizëm dhe kohezion të fortë, duke dëshmuar gatishmërinë e tyre operacionale dhe aftësinë për ndërveprim me forcat e vendeve aleate.

Ky angazhim pasqyron kontributin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë në misionet ndërkombëtare, duke forcuar partneritetin dhe bashkëpunimin në kuadër të sigurisë dhe stabilitetit rajonal.



Efektivat e Bazës së Mbështetjes dhe Emergjencave Civile përfundojnë me sukses kursin e avancuar të kërkim-shpëtimit malor në Kosovë

Efektivat e kompanisë operacionale të Bazës së Mbështetjes dhe Emergjencave Civile kanë përfunduar me sukses kursin e avancuar të kërkim-shpëtimit malor, i zhvilluar në Qendrën Ndërkombëtare të Trajnimeve për Kërkim-Shpëtim në Pozmatinë, Kosovë.



Ky trajnim kontribuoi në rritjen e profesionalizmit të trupës, përmirësimin e aftësive praktike në operacionet e shpëtimit si dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet forcave tona dhe partnerëve në fushën e emergjencave civile.

Pjesëmarrja në këtë kurs tregon angazhimin e vazhdueshëm të Forcave të Armatosura për të qenë gjithnjë më të gatshme dhe të përgatitura për përballimin e situatave të emergjencës.



Stërvitje e përbashkët detare mes Anijes “Lissus” dhe “RUEGEN” në Detin Egje

Efektivi i Anijes patrulluese “Lissus” P-133, zhvilloi një stërvitje të përbashkët me anijen flamurtare gjermane “RUEGEN” A-1453, në kuadër të misionit të NATO-s në Detin Egje.

Gjatë aktivitetit, u ushtruan disa skenarë të planifikuar stërvitor, përfshirë komunikimin përmes flamujve sinjalizues dhe manovrën detare “Sailing Pass”.

Qëllimi i stërvitjes ishte rritja e ndërveprimit ndërmjet ekuipazheve, forcimi i bashkëpunimit dypalësh në det, si dhe përmirësimi i aftësive për kryerjen e operacioneve të përbashkëta detare.

Kjo aktivitet konfirmon angazhimin e Forcës Detare në përmirësimin e standardeve të Aleancës dhe forcimin e kapaciteteve ndërvepruese në operacionet detare.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Si mund të heshtësh?!
Ka vargje që nuk i lexon, por i ndien si therje në shpirt. Janë ato fjalë që të zgjojnë kujtesën e gjakut, të kujtojnë se kush je, pse je dhe pse nuk mund të heshtësh.
Këtu nuk ka vend për metafora të buta. Këtu flitet për gjak, për shkronja, për këngë, tre elementë që, kur bashkohen, japin kuptimin e pavdekësisë së një kombi.

Gjaku që s’u tret, por u bë fjalë...
Historia shqiptare është e mbushur me plagë. Por ajo që e bën të pazakontë është se plagët nuk u lanë të mbyllen në harresë. Gjaku nuk u la të thahej, pa shënuar histori, ai u mblodh dhe u kthye në fjalë, në poezi, në këngë.
Ky është një akt i jashtëzakonshëm i kujtesës kombëtare, të mos harrosh, por të shndërrosh dhimbjen në forcë dhe në identitet.

Një komb që ringjallet nga rrënojat
“Bota që kur është zënë, Shqipëria gjallë ka qenë”, deklaratë që tejkalon historinë e dokumentuar, historia jonë e dëshmon sa herë është menduar se Shqipëria u shua, ajo është ringjallur. Nga pushtimet, nga copëtimet, nga heshtja. Ajo ka lindur sërish, sepse rrënjët e saj janë në gjak, jo në letra diplomatike.

Nga gjaku në këngë, pavdekësia e shpirtit shqiptar...
Nëse kombet maten nga aftësia për të luftuar, shqiptarët kanë luftuar jo më pak se kombet e tjerë. Por nëse kombet maten nga aftësia për të kënduar dhimbjen dhe për ta kthyer atë në art, shqiptarët janë unikë. Lahuta e malësorëve, vajtimet e grave shqiptare, vargjet e rilindësve të gjitha janë dëshmi se ky popull nuk e la dhimbjen të mbytet në heshtje, por e shndërroi në trashëgimi. Kënga ka qenë arma jonë e dytë, pas pushkës. Dhe shpesh, më e fortë se pushka. Sepse armët mbarojnë, kufijtë ndryshojnë, por kënga mbetet, udhëton brez pas brezi, ringjall ndjenjën e përbashkët dhe e bën Shqipërinë të përhershme. Në një kohë kur globalizmi i zhduk ngjyrat kombëtare, kënga jonë është alarmi që na paralajmëron: kujdes, mos harroni kush jeni!

Shqipëria nuk ka moshë...
Shqipëria, nuk është thjesht një vend i vogël në hartë. Ajo është si një ide universale, një frymë që ka lindur bashkë me botën. Shqipëria nuk ka moshë. Ajo lindi qysh kur mbi tokë lindi njerëzimi, dhe kjo është e shkruar jo veç në copa letrash, por në vetë ekzistencën e popullit që e mban gjallë.
Nëse duam të meritojmë këtë trashëgimi, le të japim secili sot pjesën tonë, që gjaku i të rënëve të mos kthehet në harresë, por të mbetet përjetësisht këngë. Historia shqiptare është një kalvar plagësh, pushtime, copëtime kufijsh, tradhti diplomatike. Por ajo që e bën Shqipërinë të jashtëzakonshme është fakti se plagët nuk u lanë të mbyllen në heshtje. Gjaku i derdhur nga të parët nuk u shpërdorua, ai u mblodh, u shkrua dhe u këndua, duke u bërë trashëgimi e përjetshme dhe forcë e identitetit tonë kombëtar.

Çdo këngë kreshnike, çdo vajtim popullor nuk është thjesht art, është një akt kujtese dhe rezistence. Shqiptarët nuk kanë lejuar që dhimbja të shndërrohet në gjurmë të fikura. Përkundrazi, e kanë kthyer dhimbjen në forcë. Ky shndërrim i humbjes në këngë, i tragjedisë në identitet, është një fenomen i rrallë kulturor, garancia e pavdekësisë sonë.
Një popull që di të këndojë mbi gjakun e tij nuk mund të zhduket.
Këto vargje nuk janë thjesht poezi, ato janë një testament, një thirrje që na kujton se nuk mund të heshtim. Heshtja është vrasja e dytë e Shqipërisë, më e rrezikshme se çdo pushtim.

Gjaku u bë fjalë, fjala u bë këngë, kënga u bë Shqipëri
Tani është radha jonë: këndimin ta kthejmë në vepër.

Gjaku u bë fjalë, fjala u bë këngë, tani radha është e jona...



Vetëm kështu do ta mbajmë Shqipërinë të përjetshme, të gjallë që nga zanafilla e botës.

Shqipëri... gjaku në vena thërret!
Në damarët tanë nuk rrjedh vetëm gjak, por histori. Çdo rrahje zemre është një kujtesë e gjallë e sakrificave të brezave që derdhën jetën për këtë tokë. Sot, kur shumë të rinj e shohin shpëtimin te një biletë avioni, thirrja e gjakut bëhet edhe më e fuqishme: mos e braktis Shqipërinë, sepse ajo jeton vetëm përmes jush.

Kur të rinjtë ikin, Shqipëria zbehet...
Emigrimi nuk është fenomen i ri, por sot ka marrë përmasa alarmante. Shkollat boshatisen, fshatrat mbeten pa zë, qytetet humbasin energjinë e rinisë, që duhej të ishte motori i tyre.
Çfarë kuptimi ka të këndojmë për Shqipërinë e përjetshme, nëse nesër këto këngë nuk ka kush t’i këndojë? Shqipëria nuk mund të mbijetojë thjesht si kujtim folklorik. Ajo ka nevojë për rininë e saj, për energjinë, ëndrrat dhe guximin që ta ndërtojë dhe ta mbajë gjallë.

Gjaku i derdhur kërkon përgjigje...
Gjaku i të rënëve nuk u tret, ai u shndërrua në fjalë dhe këngë që përçojnë kujtesën dhe krenarinë kombëtare. Por sot, çfarë ndodh kur kënga mbetet e mbyllur në libra, ndërsa të rinjtë largohen pa kthim?
Gjaku i derdhur për këtë tokë nuk kërkon lavdi të shkuar,

ai kërkon përgjigje në të tashmen. Dhe përgjigjja është e thjeshtë, por thelbësore qëndrim, ndërtim, përkushtim. Vetëm kështu mund të mbajmë gjallë historinë, identitetin dhe shpirtin e Shqipërisë.

Rreziku i heshtjes...
Armiku më i madh i një kombi nuk është gjithmonë i huaji, por heshtja e bijve të vet. Sot, rreziku nuk vjen nga pushtimet, por nga braktisja e heshtur.
Kur një i ri largohet pa kthim, nuk humbet vetëm një individ, por një copë e së ardhmes së vendit. Dhe nëse ky proces vazhdon, atëherë kënga jonë kombëtare rrezikon të mbetet jehonë pa zë.
Mos e shihni Shqipërinë si barrë. Shikojeni si sfidë, si fushë të pashkelur ku mund të lini gjurmë.

Kombi nuk jeton vetëm me kujtime, por me vepra. Dhe veprat nuk do t’i bëjë askush tjetër për ne, as Europa, as Amerika.
Veprat e Shqipërisë do t’i bëjmë vetëm ne, ose nuk do të bëhen kurrë.

Thirrja e gjakut
Shqipëria nuk ka moshë. Ajo jeton aq sa jeton në venat tona. Dhe venat e sotme janë venat e rinisë shqiptare. Nëse ato thahen larg atdheut, Shqipëria mbetet pa gjak.
Prandaj, mos harroni, gjaku në vena thërret. Ai nuk ju thërret për nostalgji, por për përgjegjësi. Shqipëria jeton vetëm nëse ju e mbani gjallë.



INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Gratë që thyejnë tabutë: Forca dhe guximi mbi uniformë

Në një botë ku forca shpesh shihet si atribut mashkullor, historitë e grave që ndërtojnë karrierë në Forcat e Armatosura frymëzojnë dhe tregojnë se vendosmëria nuk njih kufij. Nënkolonele Arjana Stërgu, me përkushtim, disiplinë dhe pasion për profesionin, ka ndërtuar një rrugëtim të spikatur në shërbim të vendit. Në këtë intervistë për gazetën “Ushtria”, ajo ndan me lexuesit rrëfimet e saj mbi sakrificat, sfidat, misionin dhe vizionin që e kanë shoqëruar në çdo hap të karrierës ushtarake.

Një jetë mes uniformës dhe familjes, rrëfimi i nënkolonel Arjana Stërgut

E lindur dhe e rritur në një familje me disiplinë të hekurt, me figurën e një babai model, të devotshëm dhe të përkushtuar pas familjes dhe punës, me figurën e një nëne, që sakrifikonte po aq sa babai për të na siguruar një të ardhme të ndritur, me moton që na shoqëronte çdo ditë “Gjithçka fitohet me djersë”, në dyshen “Inxhinieri Mekanike” dhe “Oficere”, zgjedha variantin e dytë. E them me bindje të plotë, që kam bërë zgjedhjen e duhur, sepse ky është një profesion fisnik. Çdo ditë, që prej ditës së parë kur nisa fakultetin dhe deri më sot i jam përkushtuar plotësisht këtij profesioni dhe kam punuar me pasion dhe përgjegjësi.

Nënkolonele Arjana, le të nisemi nga përditshmëria juaj. Si është një ditë në Akademinë e Forcave të Armatosura?

Që prej orës 06:00 të mëngjesit deri në orën 19:00 të mbrëmjes më duhet të qëndroj larg shtëpisë dhe familjes sime, nga e hëna në të premte. Shoqet më thonë: “Je heroinë, që udhëton çdo ditë, që lodhesh dhe sakrifikon kaq shumë”. Nisem nga Elbasani, me kokën pas dhe mendjen te familja dhe kur mbërrij në garnizonin “Skënderbej”, më kap rutina e punës, futem thellë në botën e shkresave të shumta në numër, në atë ekranin e kompjuterit, ku me gjuhën e zerove dhe njëshave përkethehet çdo shkronjë, numër apo simbol që unë shkruaj në tastierë. Si çdo profesion dhe punë, edhe kjo ka vështirësi, por në të njëjtën kohë të përcjell edhe kënaqësi, pasi je gjithmonë në vijën e parë të frontit, në gatishmëri për të mbrojtur familjen që e ke kilometra larg dhe bijtë e bijat e atdheut tënd.

Nënë mbi gjithçka: Grada që nuk matet me medalje Ju jeni edhe nënë. Si e përjetoni këtë rol paralelisht me përgjegjësitë ushtarake?

Të jesh nënë është dhurata më e madhe dhe privilegji më i lartë që të jep jeta. Fëmija është thesari më i çmuar i një njeriu, strehë shpirtërore ku çdo prind, pas një dite të lodhshme e të ngarkuar me përgjegjësi, gjen qetësi. Një përqaftim i ngrohtë i fëmijës ka fuqinë magjike të shuajë çdo lodhje, të shërojë çdo shqetësim. Roli i nënës është shumëdimensional. Nuk është vetëm ai i sjelljes së jetës, por edhe i edukatores, psikologes, motrës, shoqes së ngushtë. Në profesion je i specializuar vetëm në një drejtim, por në familje, si nënë, je thirrja e pazëshme që të atribuon detyra dhe përgjegjësi që ky rol të dikton. Përkushtimi yt duhet të jetë i plotë, sepse çdo etapë e rritjes së fëmijës është e shtrenjtë dhe nuk duhet humbur asnjë çast i saj. Deri në vitin 2014, unë pata fatin të jem pranë vajzës sime në çdo hap, në çdo fazë të rritjes e edukimit të saj, pasi puna ime ishte vetëm katër kilometra larg shtëpisë. Por që nga ai vit, rruga ime më çoi në Tiranë. Distanca më detyroi të mungoj shpesh, të shkëmbej me të më shumë fjalë përmes telefonit sesa përqaftime. Këto 11 vite më dhanë shumë si oficer: rritje në gradë, përparim në detyrë, një karrierë që më formoi profesionalisht, por që njëkohësisht më rriti edhe ngarkesën e mungesave në familje. Vajza ime, megjithatë, e ka përballuar këtë sfidë me forcë dhe pjekuri. Ajo e ka mbushur boshllëkun e pranisë sime me mësim, duke arritur rezultate të shkëlqyera në çdo cikël studimi. Kam qenë me fat që kam pasur pranë prindërit e mi, të cilët me dashuri e përkushtim kanë mbushur shumë prej boshllëqeve të mia, duke e bërë vajzën të mos ndjejë mungesën e plotë të nënës. Por, ka një



Nënkolonele Arjana Stërgu

Përtej uniformës: Nënë përjetësisht, heroinë çdo ditë



fjalë të saj që më ndjek gjithmonë: “Mami, këto 11 vite të kanë lodhur shumë. Frytet e karrierës i ke marrë, por në shtëpi kemi pasur shumë mungesa”. Këto fjalë janë pasqyra më e vërtetë e sakrificës sime: mes uniformës dhe përqaftimit, mes gradës dhe kohës së humbur, mes krenarisë dhe mallin për praninë. Mbi çdo uniformë, mbi çdo gradë e mbi çdo arritje profesionale, qëndron zemra e një nëne. Dhe kjo zemër rreh gjithmonë për fëmijën e saj, pa njohur lodhje, pa numëruar mungesa, pa kërkuar kurrë shpërblim. Karriera më ka dhënë vlerësim dhe nder, por është vajza ime ajo që më ka dhënë kuptimin më të madh të jetës. Çdo sakrificë e imja ka qenë një investim në të ardhmen e saj. Dhe edhe pse koha shpesh më ka marrë praninë, nuk ka arritur kurrë të më marrë dashurinë. Dashuria e nënës është ajo urë e padukshme që e lidh çdo ditë me fëmijën,

pavarësisht distancave, pavarësisht orëve të gjata të punës, pavarësisht sfidave që sjell jeta. Unë mbetem nënë përjetësisht me uniformë apo pa uniformë, me gradë apo pa gradë dhe kjo është grada më e lartë që mund të më jepet ndonjëherë.

Po si bijë, çfarë raporti keni me familjen tuaj të origjinës?

Raporti im me familjen e origjinës është i pazëvendësueshëm. Prindërit e mi kanë qenë gjithmonë pranë meje, në çdo hap të jetës, pa më lënë kurrë të ndjehem vetëm. Babai, fatkeqësisht, u nda shumë herët nga jeta, dhe tashmë janë plot 9 vite që nuk e shoh, nuk e përqafoj, nuk e thërras më “babi”. Më mungon çdo ditë ajo biseda e ngrohtë me të, mendimet e tij të qarta dhe të drejta, prania e tij e palodhur. Ai ishte një njeri i jashtëzakonshëm, gjithmonë i gatshëm, kudo e kurdo, për çdo nevojë që kisha. Nuk e kam dëgjuar kurrë të thotë “S’kam kohë”. Ishte mishërim i sinqeritetit dhe korrektësisë, një model njeriu që e bart me vete edhe vajza ime sot – dhe kjo më mbush me krenari. Dita kur ndërroi jetë, është një kujtim që më përvëlonte zemrën. Isha në punë, përballë kompjuterit, kur e dëgjova për herë të fundit në telefon duke më dhënë porosi për vajzën. Pak çaste më vonë, mora telefonatën e motrës, dhe fjalët e saj “Babi s’po merr frymë” më thyen shpirtin. Djersë të ftohta më përshkuan trupin, lotët më rridhnin pa pushim, e mu duk sikur u shua një pjesë e imja. Që nga ai moment, babai u kthye në engjëllin tim mbrojtës – për mua, për vajzën time, për mamanë dhe për gjithë familjen.



Megjithatë, Zoti na la pranë mamanë, forcën dhe dritën tonë. Ajo ka qenë gjithmonë e përkushtuar, sidomos ndaj vajzës sime, duke e rritur me dashuri dhe kujdes të pashoq. Për këtë, jam pafundësisht mirënjohëse.

Koleget dhe kolegët shpesh ju përshkruajnë si një mike e mirë. Çfarë vendi ka miqësia në jetën tuaj?

Miqësia është si një portë magjike: e hap me besim dhe sapo kalon pragun e saj, aty brenda të pret një botë ngrohtësie. Është streha ku gjen mbështetje kur ndihesh e brishtë, fjalën e urtë që të udhëzon në dyshim, buzëqeshjen që të shuan trishtimin dhe dritën e optimizmit kur hija e pesimizmit të ka pushtuar. Por sot, fjala “miqësi” duket se ka humbur nga thjeshtësia e dikurshme. Interesat, servilizmi dhe llogaritjet e fshehta shpesh e turbullojnë pastërtinë e saj. Mund të kesh shumë kolege të mira, shoqe të afërta me të cilat ndan ditë e çaste, por mikeshatë vërteta ato që zemrën ta prekin pa kushte e pa hatër mbetje, janë gjithnjë e më të rralla. Jeta me ritmin dhe sfidat e saj ka ndryshuar shumë nga nuancat e dikurshme, duke shndërruar edhe mënyrën si i jetojmë marrëdhëniet. Por, qoftë në jetën civile, qoftë në atë ushtarake, ku detyra dhe sakrifica marrin përmasa të tjera, mbetet e pandryshueshme e vërteta se marrëdhëniet njerëzore janë busulla që e mbajnë shpirtin të drejtë. Pa miqësi, njeriu ecën, por ecja e tij është e zbrazët; me miqësi të sinqertë, çdo hap merr kuptim.

Shërbimi në Forcat e Armatosura shpesh është i mbushur me sfida. Cilat kanë qenë momentet më të vështira për ju?

Dy prej stacioneve më të vështira të jetës sime kanë qenë si hije të rënda që më vunë në provë: periudha e daljes në rezervë, në vitet 1996–1999, pas shkrirjes së repartit të Tankeve, dhe më pas tetori i vitit 2014, kur humba vendin e punës në repartin e Menglit, në Elbasan. Në të dyja këto çaste, ndjeva sikur toka më rrëshqiste nën këmbë. Shpresa u zbeh, motivimi u shua, dhe një vel pesimizmi më mbështolli shpirtin. Sepse humbja e punës nuk është vetëm humbje e një rroge ajo është humbje e misionit, e pasionit, e mundësisë për t’u përmirësuar, për t’u



ngjitur më lart në shkallët e karrierës. Është ndjenja e rëndë e ndërprerjes së një rruge që ke ndërtuar me përkushtim dhe mundim. E megjithatë, edhe në ato periudha të errëta, brenda meje ruhej një fije drite bindja se përtej dhimbjes, sakrificës dhe

brendshme nuk lind në ditët e qeta, por në stuhitë që duket sikur të shkatërrojnë. Dhe unë e gjeta këtë forcë tek vetja, tek familja, tek besimi se asnjë humbje nuk është përfundimtare nëse zemra nuk dorëzohet. Rikthimi në karrierë ishte prova se rruga ime nuk mbyllej aty. Çdo gradë, çdo arritje, çdo hap i mëvonshëm ishte një dëshmi se pas shiut, qielli mund të hapet sërish. Sot, kur shoh prapa, e di se ato periudha të errëta nuk ishin fundi, por gurët e themelit mbi të cilët ndërtova qëndrueshmërinë time. Sepse humbjet janë pjesë e udhëtimit, por forcën për t’u ringritur e bart vetëm ai që beson. Dhe unë zgjodha të besoj.

Si është të jesh grua në një profesion që tradicionalisht shihet si “i burrave”?

Për shumë vite në Elbasan, isha e vetmja grua me grada të larta ushtarake. Më njihnin shpesh me uniformë, dhe njerëzit ndalonin të habitur, sikur përpara tyre të ishte shfaqur diçka e pazakonshme. Shpesh dëgjoja pyetje të tilla: “Më falni, jeni oficerë e policisë?”, sepse mendja e tyre nuk e pranonte lehtë që një grua të mbante mbi supe grada ushtarake.

Dhe unë buzëqeshja. Jo vetëm për pyetjen, por për faktin që, pa e kuptuar, kisha thyer një tabu të rrënjësor thellë: atë ide të ngurtë se vetëm burri është i aftë të mbajë uniformë, të komandojë, të jetë oficer. Ishte një fitore e heshtur, një dëshmi që rrëzonte paragjykimet dhe hapte shtigje të reja për gratë që do të vinin pas me ëndrrat e tyre.

Uniforma, mbi supe të një gruaje, nuk ishte më një çudi, ishte një simbol i forcës, i barazisë dhe i guximit për të mos pranuar kufizime.

Përveç ushtrisë dhe familjes, cilat janë pasionet apo gjërat që ju japin qetësi?

Pasionet e mia lidhen me të lexuarin e romaneve, kryesisht



humbjes, ekziston gjithmonë një mundësi për t’u ringritur. Sepse, ndonëse ato periudha më lanë plagë të thella, ato u shndërruan edhe në shkollën më të ashpër të jetës. Aty ku humbja më rrëzoi, vullneti më mësoi të ngrihem. Aty ku dera e një reparti u mbyll, guximi më shtyu të kërkoj dritaren e një mundësie të re. Forca e

ata me tema shoqërore, libra me lidhshëm, lundrimi në faqet e internetit, duke lexuar materialet për të rejtat në mjekësi, ndjekja e emisioneve televizive dhe mbi të gjitha punët e shtëpisë. Fundjavave u hyj me themel pastrimit dhe larjes së shtëpisë, për ta mbajtur sa më të pastër.

Çfarë mesazhi keni për vajzat dhe gratë që ëndërrojnë të ndjekin karrierën ushtarake?

Ndiq ëndrrën! Nëse zgjedh profesionin që ëndërron, do të punosh gjithmonë me pasion dhe do të tregosh përherë përkushtim. Kur çdokush e gjen veten në punën që bën, atëherë do të ndjehet i qetë, do të punojë me kënaqësi, duke anashkaluar ata zëra që nuk e lejojnë që të punojë dhe duke u kapur fort pas qëllimit dhe objektivave që i ka vendosur vetes.

Unë u them atyre: besoni tek vetja, punoni fort, dhe mos lejoni që askush të vendosë kufij për ëndrrat tuaja.

Uniformë, gradë dhe zemër nënë: Historia e një jete

Pas uniformës të gjelbër fshihet një botë e tërë përvojash dhe përgjegjësisë. Nënkolonele Arjana Stërgu është nëna që përqafton me dashuri, bija që ruan nderin e familjes, mikja që qëndron pranë kur nevojitet dhe ushtarakja që shërben me përkushtim. Historia e saj më shumë se një rrëfim personal është një dëshmi e fuqisë dhe guximit të grave shqiptare në Forcat e Armatosura, një dritare që frymëzon brezat e rinj për të ëndërruar lart, për të thyer tabu dhe për të dhënë kontributin e tyre me krenari.



Nga Tradita në Modernitet 68 Vjet Shërbimi Hidrografik Shqiptar

Më 25 shtator 1957, u themelua Shërbimi Hidrografik Shqiptar (SHHSH), si domosdoshmëri për sigurimin hidro-lundrimor të anijeve në ujërat tona territoriale. Sot, 67 vjet më pas, ky institucion mbetet themel i sigurisë detare dhe zhvillimit të infrastrukturës blu të vendit.

Nderim dhe mirënjohje i shkojnë personelit të parë, që me përkushtim hodhi bazat e këtij shërbimi:

- Komandant, Kapiten i Rangut II, Arqile Papadhimetri,
- Zëvendëskomandant, Kapiten i Rangut III, Kiço Lati,
- Shef i Hidrografisë, Kapiten i Rangut III, Mersin Shqypi,
- Shef i sinjalistikës detare, Kapiten Teufik Digli,
- Shef i sinoptikës, Kapiten Seit Berisha.

Tradita hidrografike në Shqipëri shënohet që në fund të shek. XIX, kur specialistë austro-hungarezë dhe më pas italianë realizuan hartat e para detare dhe vendosën faro-fenerët e parë në bregdetin tonë. Në vijim, specialistët shqiptarë krijuan hartat e para zyrtare “paper charts”, duke aplikuar standardet e Organizatës Ndërkombëtare Hidrografike (IHO).

Nga tradita në modernitet

Hidrografia dhe hartografi detar sot janë të pandashme nga zhvillimi i ekonomisë blu dhe menaxhimi i burimeve mbi e nënujore. Anëtarësimi i Shqipërisë në:

- Organizatën Ndërkombëtare të Hidrografisë (IHO),
- Organizatën Ndërkombëtare të Ndihmës në Lundrim (IALA), si dhe në
- Komisionin Hidrografik të Detit Mesdhe dhe Detit të Zi (MBSHC),

e ka bërë vendin tonë pjesë të forumit ndërkombëtar ku merren vendime për sigurinë lundimore, kufijtë detarë dhe standardet hidrografike.

Këto anëtarësime sollën përfitime të rëndësishme:

- Trajnine dhe kualifikime falas për specialistët shqiptarë,
- Rritje të kapaciteteve teknike dhe operacionale,
- Pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare,
- Përfshirje në bashkëpunime rajonale për matje batimetrike, hartografi dhe sinjalistikë detare.

Sfida dhe prioritetet

Sot SHHSH ka një rol të pazëvendësueshëm për sigurinë e tregtisë detare dhe lundrimit në Adriatik e Jon. Hartat, udhëzuesit e lundrimit, listat e fenerëve dhe botimet e tjera detare janë garanci për shmangien e fatkeqësive në det.

Prioritetet e punës në vijim mbeten:

1. Përpilimi dhe publikimi i hartave të reja detare (letër & elektronike).
2. Modernizimi i sinjalistikës detare, me instalimin e fenerëve të rinj.
3. Pjesëmarrja në konferenca dhe seminare ndërkombëtare për rritjen e kapaciteteve.
4. Forcimi i bashkëpunimit me IHO, IALA dhe MBSHC.
5. Krijimi i bazës ligjore të posaçme për funksionimin dhe shërbimet e SHHSH.




TRADITA HIDROGRAFIKE NË SHQIPËRI SHËNOHET QË NË FUND TË SHEK. XIX, KUR SPECIALISTË AUSTRO-HUNGAREZË DHE MË PAS ITALIANË REALIZUAN HARTAT E PARA DETARE DHE VENDOSËN FARO-FENERËT E PARË NË BREGDETIN TONË. NË VIJIM, SPECIALISTËT SHQIPTARË KRIJUAN HARTAT E PARA ZYRTARE “PAPER CHARTS”, DUKE APLIKUAR STANDARDET E ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE HIDROGRAFIKE (IHO).

Një det i sigurt, një ekonomi e fortë

Shërbimi Hidrografik Shqiptar, në bashkëpunim me Forcën Detare dhe partnerët ndërkombëtarë, do të vijojë misionin e tij fisnik: sigurimin e një lundrimi

të sigurt, mbrojtjen e mjedisit detar dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të pasurive që ofron deti. Deti është e ardhmja jonë dhe SHHSH mbetet garant i sigurisë dhe zhvillimit të tij.



Krijimi i Brigadës së Nëndetëseve të Forcave Detare Shqiptare

Më 21 shtator të vitit 1958, në historinë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë u shënuar një ngjarje e veçantë dhe me rëndësi strategjike për mbrojtjen e atdheut. Në këtë datë, në Bazën Detare të Pashalimanit, u krijua Brigada e Nëndetëseve, një njësi elitare që do të përbënte krenarinë e Forcave Detare Shqiptare për gati katër dekada me radhë.

Dhënia e nëndetëseve nga Bashkimi Sovjetik

Në kuadër të marrëdhënieve të ngushta me Bashkimin Sovjetik gjatë viteve '50, Shqipëria përfitoi katër nëndetëse të tipit Projekt 613 (Klasa "Whiskey"). Këto ishin mjete moderne për kohën, të ndërtuara sipas përvojës së Luftës së Dytë Botërore dhe të afta për misione të gjata nëndetare.

Ardhja e tyre shënoi një risi absolute për Forcat tona të Armatosura: për herë të parë, Shqipëria kishte në zotërim armën strategjike të nëndetëseve, të afta për të mbrojtur brigjet, për të kontrolluar hapësirën detare dhe për të frenuar çdo kërcënim të huaj.

Baza Detare e Pashalimanit, qendra e Brigadës

Nëndetëset u vendosën në Pashaliman, në afërsi të Vlorës, ku u ngrit infrastruktura e nevojshme për funksionimin e tyre. Pashalimani u kthye në bazën më të rëndësishme detare të vendit, duke marrë një rol qendror në mbrojtjen e Adriatikut dhe Jonit.

Krijimi i Brigadës së Nëndetëseve i dha Shqipërisë një peshë të re në rajon. Në kushtet e Luftës së Ftohtë, kur tensionet mes Lindjes dhe Perëndimit ishin të mëdha, prania e nëndetëseve shqiptare ishte një faktor jo vetëm ushtarak, por edhe politik.

Roli gjatë Luftës së Ftohtë

Pas prishjes së marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik në vitin 1961, Shqipëria ruajti katër nëndetëset, duke u bërë i vetmi vend i vogël socialist që i zotëronte ato në mënyrë të pavarur. Për dekada me radhë, këto mjete kryen misione stërvitore, patrullime dhe ruajtje të hapësirës detare shqiptare.


Nëndetëset e Brigadës shërbyen si garanci e sovranitetit detar, duke i dhënë vendit tonë një armë të fuqishme frenuese. Stërvitjet e shumta me ekuipazhet shqiptare treguan profesionalizëm dhe përkushtim, duke i bërë marinarët tanë të njohur për disiplinën dhe guximin.

Fund i një epoke

Me kalimin e viteve dhe zhvillimet e reja politike e ekonomike, nëndetëset u nxorën jashtë shërbimit. Ato u përdorën deri në mesin e viteve '90, duke shënuar gati 40 vjet shërbim të pandërprerë. Në vitin 1997, Brigada e Nëndetëseve praktikisht pushoi së ekzistuari.

Megjithatë, kujtimi i saj mbetet gjallë. Një prej nëndetëseve të klasës "Whiskey" është sot e ekspozuar në Pashaliman, duke

Pashalimani, djepi i Brigadës së Nëndetëseve, krenari e Forcave të Armatosura



u kthyer në një simbol të trashëgimisë detare të Shqipërisë dhe një dëshmi e sakrificës e përkushtimit të brezave të marinarëve shqiptarë.

Nëndetësja 105, simbol i fuqisë detare shqiptare

Në historinë e Brigadës së Nëndetëseve, një vend të veçantë zë Nëndetësja 105, njëra nga katër nëndetëset e tipit Projekt 613 (Klasa "Whiskey") që iu dhuruan Shqipërisë nga Bashkimi Sovjetik në vitin 1958. Ajo u bë jo vetëm një mjet i rëndësishëm luftarak, por edhe një simbol i krenarisë, sakrificës dhe përkushtimit të marinarëve shqiptarë.

Nëndetësja 105 u përfshi në misione të shumta stërvitore e operacionale gjatë dekadave të shërbimit të saj. Ajo shërbeu si shkollë e madhe profesionale për breza të tërë marinarësh shqiptarë, të cilët aty u kalitën me disiplinë, guxim dhe përvojë tekniko-ushtarake. Në kushtet e Luftës së Ftohtë, prania e saj përbënte një garanci të fuqishme frenuese kundër çdo provokimi

të huaj në hapësirat ujore shqiptare.

Shumë prej oficerëve dhe ekuipazheve shqiptare e nisën karrierën e tyre në bord të Nëndetësës 105. Ajo njihej për frymë kolektivi, solidariteti dhe gatishmëri luftarake.

Nëndetësja ishte arenë e një jete të vështirë, ku shërbimi kërkonte sakrificë të mëdha, por gjithashtu edhe një shkollë karakteri e burrërie.

Trashëgimia historike

Me daljen jashtë shërbimit të nëndetëseve në vitet '90, Nëndetësja 105 mbeti pjesë e kujtesës historike të Forcave të Armatosura.

Sot, ajo shihet si simbol i një epoke të lavdishme të flotës shqiptare, që tregoi se edhe një vend i vogël mund të zotërojë dhe të përdorë armë strategjike të nivelit të lartë.

Një prej nëndetëseve të kësaj klase është ekspozuar në Pashaliman, dhe për shumë marinarë e vizitorë, kujtesa e Nëndetësës 105 mbetet pjesë e krenarisë kombëtare.



Spitali i Përgjithshëm Ushtarak – Shtylla Historike e Mjekësisë Ushtarake Shqiptare

Nga fillesat e vështira drejt institucioneve moderne mjekësore, në shërbim të ushtrisë

Në periudhën e sundimit osman, kur Shqipëria nuk kishte shtetin e saj dhe rrjedhimisht as ushtri kombëtare, nuk mund të flitet për një shërbim shëndetësor ushtarak shqiptar. Megjithatë, në hapësirat shqiptare u dalluan disa figura të shquara të mjekësisë ushtarake që shërbenin në strukturat osmane, si p.sh. dr. Ibrahim Temo nga Struga. Por, këta mjekë nuk patën mundësinë të kontribuonin në një ushtri shqiptare, pasi ajo u formua vetëm pas shpalljes së Pavarësisë, më 28 nëntor 1912.

Fillimet institucionale të Shërbimit Shëndetësor Ushtarak

Pas krijimit të shtetit shqiptar, në dokumentet e para ligjore që rregullonin ushtrinë, si “Rregullorja e Përkohshme e Ministrisë së Luftës” e datës 22 prill 1913, përmendet për herë të parë “Shërbimi Shëndetësor” si pjesë përbërëse e strukturës ushtarake. Edhe pse kjo strukturë nuk pati kohë të vihej në funksion të plotë për shkak të zhvillimeve të shpejta politike, ajo shënon një hap të rëndësishëm drejt institucionalizimit të mjekësisë ushtarake.

Vitet 1920-1930: Themeli i mjekësisë ushtarake moderne

Në periudhën e viteve 1920-1930, me konsolidimin e shtetit dhe ushtrisë shqiptare, nisi edhe organizimi më i strukturuar i shërbimit shëndetësor ushtarak. Më 17 qershor 1924, në kohën e Qeverisë së Fan Nolit, përmendet për herë të parë Spitali Ushtarak me qendër në Tiranë. Në vitin 1926, në organikën e ushtrisë përfshiheshin pesë mjekë ushtarakë.

Bazat e mirëfillta u hodhën gjatë viteve 1928–1938, me reforma të rëndësishme për modernizimin e Forcave të Armatosura. Me Ligjin Organik të Ushtrisë dhe Xhandarmërisë të vitit 1928 dhe më pas me ligjin e vitit 1929 për organizimin e forcave të armatosura, u vendos ngritja e spitaleve ushtarake në garnizonet kryesore.

26 shtator 1929 – Datëlindja zyrtare e Spitalit të Përgjithshëm Ushtarak

Në këtë datë historike, në një godinë të re dykatëshe pranë rrugës së Dibrës në Tiranë, nisi veprimtarinë Spitali i Përgjithshëm Ushtarak, një institucion themelor në sistemin shëndetësor ushtarak shqiptar. Ishte një investim shtetëror

me një kosto prej 548.894.88 franga ari, që për kohën përbënte një ndërmarrje të madhe. Ky spital u njoh zyrtarisht në ligjet ushtarake të viteve 1931, 1934 dhe 1937, si një strukturë e domosdoshme dhe strategjike për trajtimin mjekësor të forcave të armatosura. Spitali varej drejtpërdrejt nga Komanda e Fuqive Armate dhe shërbente në garnizonin e kryeqytetit.

Mjekë të përkushtuar dhe drejtues të shquar

Në këtë institucion kanë shërbyer figura të spikatura të mjekësisë ushtarake shqiptare, si major Petraq Popa, që shërbeu në Spitalin e Elbasanit nga viti 1930, dhe dr. Sinan Imami, i cili shërbeu në spital që nga viti 1933 me gradën toger, për të marrë më vonë drejtimin e tij pas Luftës.

Përmendim gjithashtu:

- Dr. Selaudin Mborja
- Dr. Pavli Flloko
- Dr. Shan Nush Gjoka
- Dr. Spiro Prosi
- Dr. Kiço Karajani
- Dr. Shyqyri Basha
- Dr. Petraq Progri

Të shumtë ishin dhe mjekë të tjerë që kontribuan me përkushtim.

Drejtori i parë i Spitalit të Përgjithshëm Ushtarak ishte nënkolonel dr. Ismet Gega, patolog i njohur.

Gjatë pushtimit dhe Luftës Nacionalçlirimtare

Pas pushtimit fashist, më 7 prill 1939, spitali u bashkua me strukturat ushtarake të forcave pushtuese. Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare u krijuan spitale

partizane, që funksionuan në kushte të vështira, por me një organizim të admirueshëm, në përputhje me natyrën e luftës guerile.

2 shkurt 1945 – Ringritja e Spitalit në një Shqipëri të çliruar

Pas Çlirimit, më 2 shkurt 1945, u ringrit në Tiranë Spitali i Përgjithshëm (sot Qendror) i Ushtrisë, me drejtor kolonel dr. Sinan Imami, një nga figurat më jetëgjata në historinë e këtij institucioni, i cili qëndroi në detyrë deri në vitin 1973.

Pas tij, drejtimin e spitalit e morën mjekë të njohur si:

- Dr. Veli Toto
- Dr. Perlat Hodo
- Dr. Ilir Kajo
- Dr. Mihal Kërçi
- Dr. Esat Duraku
- Dr. Engjëll Mastori
- Dr. Hajri Gërbi
- Dr. Luan Nikollari, etj.

Trashëgimia dhe rëndësia historike

Spitali i Përgjithshëm Ushtarak ka qenë dhe mbetet një institucion kyç i sigurisë shëndetësore të Forcave të Armatosura Shqiptare. Historia e tij pasqyron përpjekjet dhe sakrificat për krijimin e një sistemi shëndetësor të specializuar, të qëndrueshëm dhe të denjë për të mbështetur një ushtri kombëtare në çdo kohë dhe rrethanë.

Studimi i mëtejshëm i historisë së këtij institucioni, i figurave që e drejtuan dhe i stafit që shërbeu në të, përbën një detyrim moral dhe profesional, jo vetëm për historianët ushtarakë, por për të gjithë ata që vlerësojnë rrënjët e shtet-formimit shqiptar.



Tradita dhe risia bashkohen: OSFA në festivalin ‘Korça Serenights’

Forcat e Armatosura sjellin serenatat korçare me fuqi simfonike

Në kuadër të Ditëve Europiane të Trashëgimisë Kulturore, Orkestra Simfonike e Forcave të Armatosura (OSFA), në bashkëpunim me Qendrën e Kulturës së Qytetit të Korçës, solli për publikun një mbrëmje të paharrueshme kushtuar serenatave korçare.

Nën riorkestrimin e prof. Josif Mingës, serenatat tradicionale morën një dimension të ri, duke u interpretuar në sheshin e Pazarit të Vjetër me një fuqi skenike profesionale.

Për tri net me radhë, edicioni i dytë i festivalit “Korça Serenights” mbledhi në një skenë artistë të njohur shqiptarë si Mihallaq Andrea, Bledi Polena, Ermira Kola, Frederik Ndoci, Endri & Stefi Prifti dhe Eli Fara.

Pjesëmarrja e Orkestrës Simfonike të FA-së, u cilësua një vlerë e shtuar për festivalin, duke bashkuar traditën me risinë dhe duke e ngritur serenatën në një nivel të ri artistik.

Atmosfera e tri netëve u shoqërua me praninë e mijëra qytetarëve dhe vizitorëve nga e gjithë Shqipëria, të cilët u bënë pjesë e festës muzikore duke kënduar së bashku me artistët.

Ky edicion i festivalit dëshmoi se serenata mbetet një simbol i fortë i identitetit kulturor korçar, ndërsa përfshirja e Orkestrës Simfonike të Forcave të Armatosura e pasuroi këtë traditë me një interpretim të ri, duke ruajtur autenticitetin dhe duke e bërë atë më të aksesueshme për publikun e gjerë.





KOLONEL HYSNI GJERGJI

Lufta pa kontakt (non contact warfare) është një strategji ushtarake moderne që minimizon angazhimin fizik ndërsa maksimizon impaktin strategjik, përmes mjeteve të ndryshme, përfshirë operacionet kibernetike, luftën me informacion dhe sulmet me raketa e dronë nga shumë larg. Duke iu afruar vitit 2026, vëmë re se konflikti i armatosur po kalon nga përplasja e tankeve, tek përplasja dhe ndikimi i 3 I-ve: ideve, informacionit dhe influencës janë bërë armë moderne, më të mprehta dhe më strategjike se plumbi. Ndryshimi i natyrës së betejës dhe lufta moderne nuk po ndodh më vetëm në fushëbetejë por edhe në Infrastrukturë (energji, uji, interneti), ekonomi (sanksione, sulme mbi banka) dhe opinion publik (dezinformim, propagandë online). Kjo tendencë kërkon që edhe mbrojtja të përshtatet jo vetëm me radarë dhe armë, por edhe me institucione të forta, arsim cilësor, media të pavarura dhe vetëdije kolektive që janë formësuese të 3 I-ve. Jetojmë në një botë ku më shumë njerëz “vriten” nga manipulimi sesa nga plumbi, armët e ndikimit janë armët e së ardhmes. Kjo është luftë pa uniforma, pa deklarata zyrtare, pa armë tradicionale, por me mjete të tilla si, dronë me rreze të gjatë, sulme kibernetike, operacione psikologjike, fushata dezinformimi.

“Lufta pa kontakt” është një koncept dhe komponent i luftës moderne, që nënkupton përdorimin e teknologjive të avancuara për të goditur armikun pa qenë nevoja për përplasje të drejtpërdrejta fizike ndërmjet forcave ushtarake. Qëllimi i “luftës pa kontakt” është të neutralizojë armikun nga distanca, duke reduktuar humbjet njerëzore dhe për të rritur efikasitetin operativ. Lufta pa kontakt është mënyra moderne e të luftuarit, ku teknologjia dhe distanca zëvendësojnë përplasjet klasike trup me trup. Kjo lloj lufte synon të minimizojë rrezikun për trupat e veta dhe të maksimizojë efektin përmes distancës dhe inteligjencës teknologjike. Karakteristikat kryesore të luftës pa kontakt janë përdorimi i armëve të sofistikuara me rreze të gjatë veprimi, si raketat, dronët, avionët pa pilot (UAV), artileria me precizion të lartë etj. Me anë të kësaj lufte bëhet dominimi në hapësirën kibernetike dhe informative, përmes sulmeve kibernetike, luftës elektronike, dezinformimit dhe kontrollit të komunikimeve si dhe zbulimi dhe goditja e objektivave në kohë reale, shpesh pa praninë fizike të trupave në terren. Inteligjencë artificiale dhe analizë e të dhënave për të marrë vendime taktike dhe strategjike më shpejt, janë tipare të kësaj lufte. Shembuj konkretë të luftës pa kontakt janë edhe sulmet me dronë në Lindjen e Mesme për të eliminuar objektiva terroristë pa vendosur trupa në terren.

Lufta pa kontakt ose me 3 I-të, nuk mund të ekzistojë pa inteligjencë të fuqishme pasi Inteligjenca janë “sytë dhe veshët” e liderit ushtarak dhe mjet për të fituar luftën pa pasur nevojë për betejë të drejtpërdrejtë me armë zjarri. Inteligjenca në luftën pa kontakt është procesi i mbledhjes, analizimit dhe përdorimit të informacionit mbi armikun, fushën e betejës, infrastrukturën, komunikimet, qëllimet dhe aftësitë e tij, pa patur kontakt fizik me të. Roli i inteligjencës në luftën pa kontakt është vendimtar dhe shpesh është faktori kyç që ndan suksesin nga dështimi. Në këtë lloj lufte, ku përplasjet fizike janë të kufizuara dhe sulmet ndodhin nga distanca, informacioni i saktë dhe në kohë reale është arma më e fuqishme. Sistemet ISR (Intelligence, Surveillance, Reconnaissance) janë pajisje për zbulim dhe vëzhgim në distance, të cilat përdorin taktikat “Shock and awe” (goditje e menjëhershme dhe shkatërruese), si dhe goditje masive me raketa/dronë për të paralizuar aftësinë e kundërshtarit që në fillim.

Zbulimi dhe identifikimi i objektivave është misioni kryesor i inteligjencës dhe synon të gjejë përgjigjet e pyetjeve çfarë, ku dhe kur të goditet. Kjo arrihet përmes informacionit të satelitëve, dronëve të vëzhgimit, sensorëve tokësorë ose ajrorë dhe analizës së imazheve dhe zërit të përfutur nga (SIGINT,


“ LUFTA PA KONTAKT OSE ME 3 I-TË, NUK MUND TË EKZISTOJË PA INTELIGJENCË TË FUQISHME PASI INTELIGJENCA JANË “SYTË DHE VESHËT” E LIDERIT USHTARAK DHE MJET PËR TË FITUAR LUFTËN PA PASUR NEVOJË PËR BETEJË TË DREJTPËRDREJTË ME ARMË ZJARRI. INTELIGJENCA NË LUFTËN PA KONTAKT ËSHTË PROCESI I MBLEDHJES, ANALIZIMIT DHE PËRDORIMIT TË INFORMACIONIT MBI ARMIKUN, FUSHËN E BETEJËS, INFRASTRUKTURËN, KOMUNIKIMET, QËLLIMET DHE AFTËSITË E TIJ, PA PATUR KONTAKT FIZIK ME TË. ROLI I INTELIGJENCËS NË LUFTËN PA KONTAKT ËSHTË VENDIMTAR DHE SHPESH ËSHTË FAKTORI KYÇ QË NDAN SUKSESIN NGA DËSHTIMI.

IMINT, HUMINT). Inteligjenca ndihmon për të zbuluar sulme të planifikuara kibernetike, raketore ose terroriste si dhe për t'i ndaluar ato përpara se të ndodhin. Përdorimi i AI-së dhe Big Data nga intelijenca analizon sasi të mëdha informacioni në kohë reale, lidhur me lëvizjet e trupave, komunikimet në rrjete sociale dhe aktivitetet në internet të kundërshtarit. Komandantët ushtarakë por dhe liderët politikë i bazojnë vendimet e tyre mbi inteligjencën ushtarake (p.sh. për të urdhëruar një sulm me dron apo për të bllokuar rrjetin elektrik të armikut. Përdorimi i inteligjencës është i rëndësishëm edhe për të kuptuar mendësinë e armikut dhe për të përhapur dezinformim për të krijuar konfuzion, frikë ose ndarje të brendshme, duke mos patur kontakt me të.

Operacioni Stuxnet, për shembull është një nga operacionet më të famshme të luftës pa kontakt. Stuxnet ishte një sulm kibernetik i sofistikuar, i zhvilluar nga SHBA dhe Izraeli, me qëllim për të sabotuar programin bërthamor të Iranit, pa përdorur asnjë armë fizike dhe zjarri. Filloi rreth vitit 2007–2008 (fshehtësisht)

dhe u zbulua nga ekspertët e sigurisë në qershor 2010. Qëllimi i sulmit ishte shkatërrimi i centrifugave në uzinën bërthamore iraniane të Natanz, të përdorura për pasurimin e uraniumit. Stuxnet infektonte sistemet kompjuterike industriale (SCADA të kontrolluara nga Siemens). Ky virus arriti të ndryshonte funksionimin e centrifugave, duke i bërë ato të punonin në mënyrë jo të qëndrueshme. Virusi shkaktonte dëmtime fizike, ndërsa tregonte të dhëna normale në ekranet e tyre për operatorët, në këtë mënyrë ata nuk e kuptonin sulmin. Stuxnet ishte virusi i parë në histori që shkaktoi dëme fizike përmes një sulmi digjital. Ai shënoi fillimin e epokës së luftës kibernetike si një mjet real dhe efektiv për konflikt ndërkombëtar. Pasojat për Iranin ishin të mëdha, duke arritur në dëmtimin e mbi 1,000 centrifugave (nga rreth 5,000 që Irani kishte në atë kohë). Si pasojë e operacionit u krijuan vonesa të ndjeshme në programin bërthamor, si dhe u kërkuar rritje e vigjilencës kibernetike në të gjithë vendet që kishin program bërthamor në zhvillim. Stuxnet ishte kaq kompleks, sa





besohet të jetë zhvilluar nga disa qindra ekspertë dhe ka zgjatur për disa vite me radhë. Ai nuk u përhap në internet, por fillimisht u fut përmes USB-ve të infektuara, pasi objektivi nuk ishte i lidhur me internetin.

NCW (Non Contact Wafare)

Vrasja e Qasem Soleimani është një tjetër operacion i Luftës Pa Kontakt dhe shembull klasik i operacionit të bazuar në inteligjencë dhe i ekzekutuar përmes luftës pa kontakt. Më 3 janar 2020, në Aeroportin Ndërkombëtar të Bagdadit, Irak, u ekzekutua me sulm ajror me dron MQ-9 “Reaper” Qasem Soleimani, komandant i Forcave Quds të Gardës Revolucionare Islamike të Iranit (IRGC). Operacioni i dërgoi një mesazh paralajmërues Iranit, pas sulmeve të mëparshme ndaj ambasadës amerikane në Bagdad dhe forcave amerikane.

Droni MQ-9 sulmoi me raketa “Hellfire”, duke shkatërruar makinën ku ndodhej Soleimani dhe pjesëtarë të milicive aleate. Në operacion u përfshinë mbikëqyrje satelitore, elektronike dhe njerëzore (SIGINT + HUMINT). U përdor informacion në kohë reale për itinerarin e Soleimanit nga Siria në Irak, si dhe u bashkëpunua me inteligjencën lokale (Irakiane ose aleatë të SHBA-së). Operacioni ishte i miratuar drejtpërdrejt nga Presidenti i SHBA-ve, pas analizave të informacionit të agjencive të inteligjencës. Pasojat dhe jehona ndërkombëtare të këtij operacioni ishin të rëndësishme si dhe u minua besimi dhe ndikimi iranian në Irak dhe Siri.

Sulmin rus kundër tokës polake të 10 shtatorit 2025, ka shumë komponentë të “luftës pa kontakt”. Elementi i parë është synimi i Rusisë të fshehtë gjurmët e drejtpërdrejta, pasi për këtë ka përdorur territorin e një aleati të saj satelit si Bjellorusia. Bjellorusia është de facto e kontrolluar nga Rusia në aspektin ushtarak: trupat, avionët, sistemet e radarëve rusë janë vendosur aty që nga viti 2022. Ajo lejon Rusinë të veprojë përtej kufijve të saj pa ekspozuar direkt territorin rus, ndaj ndëshkimeve ose kundërpërgjigjeve. Me Bjellorusinë si platformë për lëshimin e dronëve, Rusia shmang përgjegjësinë e drejtpërdrejtë përballë NATO-s, pasi nuk ka një “provë të fortë” që një sistem komandim-kontrolli rus, drejtoi sulmin nga territori i vet. Kjo është një teknikë klasike e shmangies së përgjegjësisë, që e lejon Rusinë të thotë: “Nuk jemi ne, mund të jetë Bjellorusia që ka vepruar vetë, ose ky është një gabim teknik”. Dronët që kalojnë kufirin në mënyrë të sinkronizuar, dhe nga shumë drejtime gjatë natës

dhe që hyjnë thellë në territor, testojnë limitet e NATO-s, por e pa kaluar “vijën e kuqe” të Nenit 5. Pas incidentit, Polonia nuk e ka kërkuar ende zyrtarisht aktivizimin e Nenit 4, që thotë “Palët do të konsultohen së bashku kur, sipas mendimit të cilitdo prej tyre, integriteti territorial, pavarësia politike ose siguria e njëjës prej tyre është e kërcënuar”. Deri në vitin 2024, Neni 4 i NATO-s është aktivizuar të paktën 8 herë, ku Turqia e ka kërkuar 4 herë; në 2003, në luftën në Irak, në 2012 nga Turqia pas rrëzimit të



SULMIN RUS KUNDËR TOKËS POLAKE TË 10 SHTATORIT 2025, KA SHUMË KOMPONENTË TË “LUFTËS PA KONTAKT”. ELEMENTI I PARË ËSHTË SYNIMI I RUSISË TË FSHEHË GJURMËT E DREJTPËRDREJTA, PASI PËR KËTË KA PËRDORUR TERRITORIN E NJË ALEATI TË SAJ SATELIT SI BJELLORUSIA. BJELLORUSIA ËSHTË DE FACTO E KONTROLLUAR NGA RUSIA NË ASPEKTIN USHTARAK: TRUPAT, AVIONËT, SISTEMET E RADARËVE RUSË JANË VENDOSUR ATY QË NGA VITI 2022. AJO LEJON RUSINË TË VEPROJË PËRTEJ KUFIJVE TË SAJ PA EKSPOZUAR DIREKT TERRITORIN RUS, NDAJ NDËSHKIMEVE OSE KUNDËRPËRGJIGJEVE.



një avioni turk nga Siria, në 2015 nga përshkal-lëzimi në kufirin sirian dhe 2020 nga vrasja e ushtarëve turq në Idlib. Në 2014 është kërkuar nga Polonia, Lituania, Letonia dhe Estonia, kundër aneksimit të Krimesë nga Rusia. Në vitin 2022 aktivizimi i nenit 4 është kërkuar nga Bullgaria, Çekia, Estonia, Letonia, Polonia, Rumania dhe Sllovakia, për rrezikun e përbashkët nga fillimi i agresionit rus në Ukrainë dhe e fundit, kur është kërkuar aktivizimi i nenit 4 të NATO-s, është në vitin 2023 nga Polonia gjatë një incidenti ku një raketë ruse bie në territorin Polak.

Në Ballkan, aktualisht po përdoren disa elemente të “luftës pa kontakt” me armët 3I, duke përdorur mjetet informative, ekonomike, teknologjike dhe psikologjike për të ndikuar ose destabilizuar pa pasur një konflikt të drejtpërdrejtë. Investimet strategjike në infrastrukturë, energji apo media po përdoren si mjete ndikimi, përmes kredive me kushte të disfavorshme, që i lidh vendet e Ballkanit me interesat gjeopolitike të aktorëve të caktuar. Korrupsioni i strukturuar dhe i financuar nga jashtë, është një tjetër armë e luftës hibride dhe pa kontakt fizik ushtarak. Borsxhet e larta ndaj investorëve kinezë në disa vende të Ballkanit po përdoren për ngritjen e bizneseve “të huaja” që përdoren për pastrim parash ose influencë politike. Hakerimi i të dhënave personale, destabilizim përmes rrjedhjes së informacionit, siç ndodhi në Shqipëri në vitin 2022 me sulmet e lidhura me Iranin është një shembull i kësaj lufte të re. Formë e kësaj, është lufta kulturore dhe ideologjike përmes përhapjes së një ideologjie të përzgjedhur përmes shkollave, organizatave fetare dhe OJQ-ve, veçanërisht në zonat me ndarje etnike (si në Bosnje, Kosovë, Maqedoni e Veriut). Media të kontrolluara nga aktorë të huaj po përhapin nar-

rativa të përpunuara, për të polarizuar opinionin publik dhe rritur mosbesimin ndaj institucioneve. Fushata dezinformuese në rrjete sociale nxisin ndarje etnike, politike apo sociale, sidomos gjatë zgjedhjeve ose krizave. Përhapje teorish konspirative, që dëmtojnë strukturat demokratike ose promovojnë interesat e aktorëve si të Rusisë dhe Kinës, përmes mediave, instituteve kulturore apo burimeve të tjera. Këto fuqi po përdorin trolle në rrjetet sociale për të manipuluar diskursin publik. “Lufta pa kontakt” është një realitet në Ballkan, ndonëse jo e dukshme.

Shqipëria, si pjesë e kësaj hapësire të brishtë gjeopolitike, është gjithashtu edhe pjesë e kësaj “beteje të heshtur”, me armët 3 I, ku influencat përplasen përmes informacionit, teknologjisë, parave dhe narrativave kulturore apo ideologjike. Në vend të armëve të zjarrit, nga kundërshtarët tanë, përdoren armët e ndikimit. Dhe në shumë raste, ato janë më efektive sesa lufta konvencionale. Ndikimi i huaj në zgjedhje, përmes mbështetjes së kandidatëve pro-rusë ose sabotimit të rivalëve pro-perëndimorë, po rritet në Bosnjë, Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi dhe Kosovë. Vazhdimi i ofensivës së Rusisë në Ukrainë, mund t'i përballë aktorët e Ballkanit Perëndimor në të ardhmen, me destabilizime serioze, përfshirë Kosovën, Bosnje-Hercegovinën, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut. Këto operacione janë më pak të kushtueshme, por dhe më efektive se format e tjera të luftës në rajonin tonë.

Trelateralja Shqipëri-Mal i Zi-Kosovë-Kroaci, është një hap i rëndësishëm kundërshtues i këtyre përpjekjeve. Marrëveshja e nënshkruar, më 18 mars 2025, doli me një deklaratë bashkëpunimi ushtarak, e cila përfshin luftën kundër kërcënimeve pa kontakt që shfaqet në format kibernetike, të dezinformimit, etj. Iniciativa e vendeve tona, ka qëllim të harmonizojë politikën e jashtme të rajonit me atë të BE-së, si dhe për të forcuar rezistencën ndaj ndikimeve të jashtme. Bashkëpunimi BE-NATO është shumë i nevojshëm për të ndalur kërcënimet hibride në Ballkan që po intensifikohen, me fokus në inteligjencë, mbrojtje kibernetike dhe mbështetje institucionale. Simpoziumet për dezinformatat, si ai në Tiranë (2023), synojnë të forcojnë rezistencën e shoqërisë civile ndaj propagandës dhe mashtrimeve që ka gjasa të vazhdojnë gjatë.

Analiza e mësipërme nuk do të thotë që lufta tradicionale do të zhduket plotësisht. Në raste të caktuara, pushtimi fizik apo prania ushtarake mund të jetë e domosdoshme. Por këto operacione do të jenë gjithnjë e më të rralla dhe të ndërthurura me operacione pa kontakt. Nëse trendet aktuale vazhdojnë në këtë mënyrë dhe

Në kohë krize si pandemia COVID-19 dhe konflikti në Ukrainë, analistët nxitojnë të kontrollojnë se çfarë ndodh me çmimin e metalit të çmuar pasi shihet si një investim i sigurt. Por, ndërsa çmimi i arit u rrit fillimisht në vitin 2020, duke arritur kulmin në 66.46 dollarë për gram më 6 gusht, ai më pas filloi të binte ndërsa paniku fillestar u zhduk. Në fakt, ai humbi më shumë se 10% të vlerës së tij që nga ato nivele maksimale. Megjithatë, paqëndrueshmëria e vazhdueshme globale ka bërë që ari tani të çmohet në 87.06 dollarë për gram, sipas BullionVault.

Ari: 87.06 dollarë për gram

Edhe pse i nderuar nga të gjithë, ari është shumë më tepër sesa një metal i shndritshëm që nxjerr një imazh pasurie. Ari mund të përdoret si përcues elektrik, ose edhe të hahet në formën e gjethes së arit, dhe mbetet një nga substancat më të shtrenjta në Tokë.



Kërpudha vemje: deri në 110 dollarë për gram

Fjala kërpudhë zakonisht nuk sugjeron diçka me vlerë të lartë, por një kërpudhë hibride vemje që jeton dhe vret vemjet mund të shitet deri në tre herë peshën e saj në ar. Kjo kërpudhë mishngrënëse është paraziti më i shtrenjtë në botë dhe shfaqet vetëm për disa javë çdo vit në pjesë të largëta të Nepalit, Indisë, Tibetit dhe Butanit. Ka qenë një përbërës kyç në ilaçet tibetiane dhe kineze për shekuj me radhë, dhe mungesa e saj dhe vështirësia për ta marrë atë do të thotë që një gram i vetëm mund të shitet për diku midis 30 dollarëve dhe, megjithëse rrallë, 110 dollarëve. Kërpudha është një burim kaq fitimprurës sa ekspertët besojnë se deri në 80% të të ardhurave familjare në Rrafshnaltën Tibetiane dhe Himalaje vijnë nga shitja e parazitit.



Helmi i gjarprit koral: 4,000 dollarë për gram

Mund të habiteni kur të mësoni se disa lloje helmi mund të sjellin një pasuri të vogël. Një nga më të shtrenjtët është helmi i gjarprit koral, i cili është i preferuar për vetitë e tij antivirale dhe antibakteriale dhe kushton rreth 4,000 dollarë për gram.




E dimë që ari është i shtrenjtë, por s'keni parë listën më poshtë...

Gjarpërinjtë koral kanë helmin e dytë më të fortë nga çdo gjarpër pas mambës së zezë dhe njihen nga ngjyrat e tyre të gjalla.



Plutoniumi: 4,000 dollarë për gram

Nëse mendoni një reaktor bërthamor, plutoniumi është përbërësi kryesor pa të cilin ai nuk mund ekzistojë. Me një çmim pothuajse të njëjtë me helmin e gjarprit të koraleve, çmimet variojnë deri në 4,000 dollarë për gram për plutoniumin. Ky kimikat radioaktiv gjendet sot vetëm në sasi gjurmësh të uranimit, gjë që e bën atë një substancë të rrallë dhe të kërkuar.



Gurë të çmuar taaffeiti: 12,500 dollarë për gram

Gurët e çmuar taaffeiti janë një milion herë më të rrallë se diamantet e zakonshme dhe mund të kushtojnë rreth 2,500 dollarë

për karat (0.2 gramë), që i bie të jetë 12,500 dollarë për gram. Edhe pse mund të jenë jashtëzakonisht të vështira për t'u gjetur, ato zakonisht përdoren në bizhuteri ultra të shtrenjta.

Soliris: 22,767 dollarë për gram

Mund të mos keni dëgjuar kurrë për të, por Soliris është një ilaç shumë i vlefshëm që përdoret për të trajtuar një sëmundje ultra të rrallë të quajtur



Redaksia e gazetës

Pikëpamjet, opinionet dhe analizat e shprehura në gazetën "Ushtria" janë tërësisht të gazetarëve apo autorëve të materialeve respektivë, sjellë pranë redaksisë së kësaj medie dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë politikat apo pozicionet zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.



Sindroma Atipike Hemolitike Uraemike (aHUS). Është gjithashtu një nga ilaçet më të shtrenjta në botë, me një çmim marramendës prej 6,830 dollarësh për një flakon 300 mg.



Tritiumi: 30,000 dollarë për gram

Tritiumi është një formë radioaktive e hidrogjenit, e njohur edhe si izotop, që prodhohet natyrshëm në atmosferën e sipërme kur gazrat dhe rrezet kozmike përplasen. Kur shihni tabelat vetëndrëquese ‘EXIT’ në ndërtesat publike, tritiumi krijon atë shkëlqim lumineshent.

Është shumë e pamundur që të keni nevojë ndonjëherë për tritium, por nëse keni nevojë, një gram është më i shtrenjtë se shumë makina të reja me 30,000 dollarë.



Benitoiti: 42,500 dollarë për gram

Me varietetet më të rralla që kushtojnë deri në 8,500 dollarë për karat - rreth 42,500 dollarë për gram - guri i çmuar blu Benitoiti është një nga substancat më të rralla të njohura nga njerëzimi. Të formuara në fazat e vona të ftohjes së një serpentinitit të ndryshuar hidrotermalisht, Benitoitet gjenden në Qarkun San Benito në Kaliforni dhe janë disa nga gurët e çmuar më të mrekullueshëm dhe më të shkëlqyeshëm në planet.



Berili i Kuq: 50,000 dollarë për gram

Berili i kuq është një nga gurët e çmuar më të rrallë në botë. Për t’ju dhënë një ide se sa i rrallë është, një kristal berili i kuq gjendet për çdo 150,000 diamante me cilësi të çmuar. Një karat (0.2 gramë) beril i kuq mund të kushtojë deri në 10,000 dollarë për mostrat më të mira, sipas kompanisë së gurëve të çmuar GemSelect. Guri i çmuar kushton rreth 50,000 dollarë për gram. Guri mund të gjendet vetëm në sasi të vogla në tre vende në botë në Utah dhe New Mexico.

Serendibiti: 90,000 dollarë për gram

Kur bëhet fjalë për gurë të çmuar të rrallë dhe të shtrenjtë, jo shumë mund të krahasohen me mineralin e hollë dhe unik inosilikat serendibit. I zbuluar fillimisht në Sri Lanka në vitin



1902, dhe më së fundmi në Mianmar, ky mineral i rrallë mund të kushtojë rreth 18,000 dollarë për karat - ekuivalent me 90,000 dollarë për gram. Disa vlerësime sugjerojnë se çmimet mund të jenë shumë më të larta, madje duke arritur në 2 milionë dollarë për karat. Me një përbërje kimike komplekse, ky inosilikat shumë i kërkuar përdoret kryesisht në bizhuteri ultra të shtrenjta.



Grandidieriti: 129,500 dollarë për gram

Sipas revistës së industrisë së bizhuterive “National Jeweler”, një gur i çmuar grandidieriti me peshë 4.96 karat (pothuajse një gram) dhe i ekspozuar në Galerinë Minerale “Wilensky Exquisite” në Nju Jork u çmua me 129,500 dollarë në vitin 2019. Kjo i bën një ons me vlerë rreth 3.67 milionë dollarë.

Guri i rrallë i çmuar u zbulua në vitin 1902 në Madagaskar. Gurët e grandieritit të pastër dhe të gradës së fasetave janë disa nga gurët e çmuar më të vështirë për t’u gjetur.



Diamantet më të rralla të pastra: 134,750 dollarë gram

Thuhet se diamantet janë “miqtë më të mirë të një vajze” - por ato janë edhe të një menaxheri banke. Edhe pse çmimi i një diamanti varet shumë nga cilësia dhe prerja e tij, një diamant i pastër një karat zakonisht varion nga 2,000 deri në 16,000 dollarë. Kjo barazohet me 10,000-80,000 dollarë për gram.

Edhe pse shumë njerëz besojnë se çmimi i madh është për shkak të rrallësisë së diamanteve, e vërteta është se jo të gjithë diamantet janë të rrallë. Por ato më të rralla janë më të shtrenjta, duke kushtuar deri në 26,950 dollarë për karat, 134,750 dollarë për gram ose 3.8 milionë dollarë për ons.



Painiti: 300,000 dollarë për gram

Painiti është një nga mineralet më të rralla të boratit në botë. U zbulua për herë të parë nga mineralogu britanik Arthur CD Pain dhe u emërua sipas tij, sipas mineralogut britanik Arthur CD Pain, i cili fillimisht mendoi se ishte safir. Minerali vjen nga Myanmari dhe mendohet se ka afërsisht 1,000 kristale painiti në qarkullim.

Meqenëse është kaq i rrallë, një karat i vetëm (0.2 gramë) Painiti mund të kushtojë 60,000 dollarë, duke e bërë një gram me vlerë 300,000 dollarë. Përdoret kryesisht për unaza fejese ultra-luksoze.



Diamante të kuq: 5 milionë dollarë për gram


Edhe pse i kemi përmendur tashmë diamantet, është e rëndësishme të theksohet se diamantet e kuqe janë gurët më të rrallë në planet dhe mund të kushtojnë rreth 1 milion dollarë për karat (0.2 gramë). Kjo e bën një gram me vlerë 5 milionë dollarë. Ka më pak se 30 diamante të kuqe të njohura për njerëzimin, shumica e të cilave peshojnë më pak se gjysmë karat. Diamanti më i madh i kuq i gjetur ndonjëherë ishte 5.11 karat në madhësi dhe u shit për 8 milionë dollarë në vitin 2011, ekuivalenti i 11.5 milionë dollarëve me paratë e sotme.



Fulerenet Endohedralë me Bazë Atomi të Azotit: 137 milionë dollarë për gram

Emri i tij nuk është aq i thjeshtë, por shkencëtarët që qëndrojnë pas Fulereneve Endohedralë me Bazë Atomi të Azotit besojnë se mund të ndryshojë të ardhmen e teknologjisë.

Materialet e Karbonit Designer në Oksford, Britani e Madhe pretendojnë se ky material i zhvilluar rishtazi - të cilin e përshkruan si “në thelb një kafaz i vogël i atomeve të karbonit, me një atom azoti brenda” - mund të përdoret për të krijuar orë të vogla atomike, të cilat matin kalimin e kohës, duke monitoruar frekuencat e atomeve. Aktualisht, orët atomike mund të jenë aq të mëdha sa një dhomë e tërë, por ky pluhur mund të krijojë alternativa që janë mjaftueshëm të vogla për t’u futur në një telefon inteligjent. Një sasi e Fullereneve Endohedral me Bazë Atomi të Azotit u shit së fundmi për 137 milionë dollarë për gram. Është cilësuar si “gjëja më e shtrenjtë në Tokë”. Por çuditërisht, ka edhe një artikull në listën tonë dhe kushton 44,000 herë më shumë...



Antimateria: 62.5 trilion dollarë për gram

Nëse mendonit se antimateria ekzistonte vetëm në fantashkencë, mendojeni përsëri. Në vitin 1999, shkencëtarët e NASA-s parashikuan se do të kushtonte 62 trilion dollarë për të prodhuar një gram antimaterie. Ata kishin pothuajse të drejtë: sot, çmimi është rreth 62.5 trilion dollarë për gram, sipas Steven Farmer, autorit të “Strange Chemistry”. Disa thonë se në vitet që vijnë, kjo substancë e veçantë do të nxisë udhëtimet hapësinore ndërgalaktike, por për momentin, kjo mbetet në sferën e fantashkencës...



PROFESIONI NË TEKNIKËN AJRORE

Një mundësi unike për të rinjtë

Forcat e Armatosura ofrojnë një mundësi të veçantë për të rinjtë dhe të rejtat që dëshirojnë të ndërtojnë një karrierë në shërbim të sigurisë së vendit, duke bashkuar dijen intelektuale dhe aftësitë praktike, si në rolin ushtarak, ashtu edhe në atë civil.

Profesioni në teknikën ajrore ofron specializime si:

- Teknikë helikopteri
- Avionikë
- Pajisje speciale
- Operator bordi

Forcat e Armatosura mbeten një derë e hapur për të gjithë të rinjtë që synojnë një karrierë të qëndrueshme dhe sfiduese, duke kontribuar në mbrojtjen e vendit dhe zhvillimin profesional personal.